Lezhë, më 30.08.2023

# PROCES VERBAL

I mbajtur sot, në dt. 30.08.2023, në orën 12:00, në sallën e Bibliotekës "At' Gjergj Fishta" Lezhë, mbi mbledhjen e radhës të muajit Gusht 2023, të këshillit të Bashkisë Lezhë.

- Mbledhja u hap nga kryetari z. Ndue Luli i cili tha që si fillim është akti i dorëheqjes së këshilltares Kleventina Lleshi dhe vazhdoi me leximin e rendit të ditës si dhe dy projekt vendime të tjera shtesë.

Kryetari hodhi në votim rendin e ditës, i cili u miratua me 26 vota PRO.

- Ndue Luli: Fillojmë me shqyrtimin e dorëheqjes nga mandati si anëtare e këshillit të Bashkisë Lezhë të znj. Kleventina Lleshi.

Kush është dakord?

Miratohet me 26 vota PRO.

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me "dhënien e mandatit si anëtar i këshillit të Bashkisë Lezhë z. Shtjefën Lleshi", bazuar në Vendimin e KQZ-së për plotësimin e vakancës nga lista shumemërore e partisë.

Kush është dakord?

Miratohet me 26 vota PRO.

- Mbështetur në procedurë, kryetari lexoi formulën e betimit të këshilltarit dhe z. Shtjefën Lleshi bëri betimin si anëtar i K. B. Lezhë.
- Ndue Luli: Vazhdojmë me projekt vendimin e

radhës "Për heqjen e mandatit si anëtar i Këshillit të Bashkisë Lezhë z. Brahim Demi", i cili ka depozituar dorëheqjen.
Kush është dakord?
Miratohet me 27 vota PRO.
Vazhdojmë me projekt vendimin "Për heqjen e mandatit si anëtare e Këshillit të Bashkisë Lezhë z. Elodia Mali", e cila ka paraqitur dorëheqjen.
Kush është dakord?
Miratohet me 27 vota PRO.
Pika pitër e rendit të ditës është projekt vendim "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 korrik 2023".
Meqë nuk ka diskutime, e kalojmë në votim.
Kush është dakord?
Miratohet me 27 vota PRO.
Kalojmë te pika pitër që është projekt vendim "Për miratimin e Rregullores për ngritjen, funksionimin dhe ndërveprimin e Strukturave Komunitare në Bashkinë Lezhë".
Siç jeni në dijeni para 2 ditësh kemi zhvilluar një konsultim publik me pjesëmarrje të gjerë, administratorët e njësive, kryetarë fshatrash, por edhe shoqëri civile, shoqata, pyetësorë të cilët dhanë mendime. Secili nga ne e ka patur

me kohë në dorë draftin, ku dhe sot ne si anëtarë të këshillit kemi të drejtë dhe mundësi për të folur në lidhje me projekt-rregulloren e re.
Kush e do fjalën?
Meqë nuk ka diskutime, e hedhim në votim.
Kush është dakord?
Miratohet me 26 vota PRO.
1 abstenim - Znj. Alfride Marku.
Vazhdojmë me pikën tjetër që është projekt vendimi "Për një shtesë e ndryshim në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2023 dhe përdorim të fondit të akorduar për rritjen e pagave".
Duhet të them që disa nga komisionet e këshillit dje kanë funksionuar shumë mirë dhe dua t'i falenderoj para të gjithëve.
Në lidhje me këtë p/vendim fjalën e ka kryetari i Komisionit të Financës.

- Agostin Marku: Komisioni i Financës, Buxhetit dhe Zhvillimit Strategjik u mblodh dje dhe shqyrtoi disa projekt vendime që janë paraqitur nga bashkia.
Për sa i përket këtij projekt vendimi, mendojmë në parim se duhet kaluar. Ka një problem në lidhje me relacionin që është lënë nga drejtoria përkatëse pa u depozituar me arsyen se ka të bëjë me vendimin që kemi marrë në mbledhjen e kaluar për rritjen e pagave. Kemi një vërejtje si komision, që duhet cilësuar se cili vendim

ndryshohet dhe respektivisht edhe pikë ndryshohet.
Me këto vërejtje komisioni ra dakord që ta kalojë
dhe t'i propozojë këshillit për ta miratuar këtë
ndryshim buxhetor.
Ndue Luli: Meqë nuk ka mendime të tjera,
e hedhim në votim projekt vendimin.
Kush është dakord?
Miratohet me 27 vote PRO.
Vazhdojmë me pikën tjetër që është projekt
vendim "Për një shtesë e ndryshim në buxhetin
e Bashkisë Lezhë për vitin 2023 dhe përdorim
të fondit të emergjencës për "Rindërtimin e urës
në fshatin Kodër Mulliri, Njësia Administrative Shëngjin".
Fjalën e ka kryetari i komisionit.
Afrim Marku: Edhe për këtë projekt vendim
komisioni i Financës ra dakord që të kalohet
për miratim në këshill me ndryshimet përkatëse,
pra duke iu referuar vendimit për buxhetin.
Është gjë pozitive që të kalohet një fond i tillë
për të ndërtuar një urë që i shërben komunitetit.
Ndue Luli: Meqë nuk ka mendime të tjera, e
hedhim në votim
Kush është dakord me projekt vendimin?
Miratohet me 27 vota PRO.
Kalojmë te pika tjetër që është projekt vendim
"Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin e
KB nr. 120, datë 02.12.2022 "Për miratimin

e PBA-së 2023-2025 dhe Buxhetit të vitit 2023".
Fjalën e ka komisioni i Financës.
Agostin Marku: Ky p/vendim është brenda standarteve, i ka të plotësuara edhe ato vërejtjet që bëmë për 2 p/vendimet e para. Ne si komision ju ftojmë ta miratojmë.
Ndue Luli: Meqë nuk ka mendim tjetër, e kalojmë në votim.
Kush është dakord me projekt vendimin?
Miratohet me 26 vota PRO.
1 abstenim - znj. Alfride Marku.
Kalojmë te projekt vendimi i parë shtesë "Për përdorim fondi për mbështetje financiare për familjen e z. Alfred Dedaj"
Fjalën e ka komisioni i Financës.
Agostin Marku: Edhe ky p/vendim është brenda standarteve që kërkon ligji. Komisioni propozoi që masa e ndihmës të kalojë nga 30000 lekë në 50000 lekë. Ne e dimë dhe jemi të ndërgjegjshëm që për çdo vendim me efekte financiare duhet marrë mendimi paraprak i bashkisë dhe Drejtorisë së Financës. Fjala është për ju të bashkisë. n.q.s ne jepni okejn për këtë mendim që u shprehë në mënyrë unanime në komisionin e Financës.
Brikena Vukzeni: Jemi dakord.
Ndue Luli: A jeni dakord me projekt vendimin dhe me ndryshimin e shumës?

Miratohet me 27 vota PRO me ndryshimin e shumës nga 30000 lekë në 50000 lekë.
Kalojmë te projekt vendimi i dytë shtesë dhe i fundit "Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Lezhë nr. 120, dt. 02.12.2022 "Për miratimin e Buxhetit për vitin 2023 dhe të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025".
Edhe ky p/vendim është diskutuar në komisionin e Financës. Fjala e ke z. Agostin.
Agostin Marku: Projekt vendimi është brenda standarteve ashtu siç e kërkon ligji. Komisioni është dakord që ta kalojmë pa ndryshime.
Ndue Luli: Mepsë nuk ka mendime të tjera, e kalojmë në votim.
Miratohet me 25 vota PRO.
2 abstenim (Alfrida Marku, Donika Haxhia).
Këto ishin projekt vendimet për mbledhjen e sotme
Kalojmë te pika "Të ndryshme".
- Alfrida Marku: Përshëndetje të gjithëve.
Unë do doja të shtroja për diskutim një problematikë me impakt mjaft të rëndësishëm në opinionin publik dhe në jetën kryesisht të banorëve të qytetit të Lezhës. Vendimi për prishjen e stadiumit "Besëlidhja" propozuar nga Kryetari i Bashkisë dhe i miratuar nga Këshilli i Bashkisë mandatin e kaluar, me të drejtë ka shkaktuar një reagim

në opinionin publik, qoftë kjo për ndikimin
në infrastrukturë, ndikimin në mjedis, është një
vendim i pakonsultuar me qytetarët apo me
grupet e interesit si dhe nga ana tjetër bie
ndesh dhe me detyrimin e qeverisjes vendore,
pra të bashkisë për të promovuar sportin dhe
për të ruajtur njëkohësisht trashëgiminë dhe
historinë. 20000 m² beton z. Ndreu nuk
mendoj që është prioritet për t'i shtuar qytetit
të Lezhës. Jam plotësisht dakord që është i
domosdoshëm parkimi nëntokësor, por bashkia i
ka të gjitha mundësitë me pasuri në pronësi
të saj apo që mundet dhe t'i blejë te të
tretët për t'i vënë në dispozicion për këtë qëllim.
Për këtë arsye dhe se më sipër, bazuar dhe
në nenin 64 të Ligjit "Për Vetëqeverisjen Vendore",
pika d, duke shfrytëzuar mundësinë që drejtuesit
e bashkisë janë në këtë mbledhje, unë do
kërkoja një raportim se në ç'fazë është kjo
çështje mjaft sensitive, mjaft e kundërshtuar
nga opinioni publik dhe nga ana tjetër propozoj,
duke marrë iniciativën e përfaqësimit të shumë
qytetarëve me të cilët kemi kontaktuar, për
revokimin e vendimit për prishjen e stadiumit,
për rikthimin për rishqyrtim në këtë këshill
të çështjes së ndërtimit të parkimit nëntokësor
dhe krijimit të një procesi dixhital të

konsultimit të kësaj çështje me pyetësorët dhe grupet e interesit.
Pjerin Ndreu: Vendimi për prishjen cili është?
Alfride Marku: I nderuar, është në përndrimet tuaja. Është vendimi nr. 24, dt. 25.04.2023 i këshillit të Bashkisë Lezhë. "Për rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor".
Atëherë unë uroj që mos të ketë një vendim të tillë.
kërkoj një raportim nga ana juaj për këtë çështje.
Pjerin Ndreu: Publikisht në fushatën elektorale unë kam shpalosur vizionet tona për zhvillimin e mëtejshëm të qytetit. Një ndër idetë që kemi ne është dhe heqja e stadiumit nga aty dhe ndërtimi i një qendre multifunksionale sportive. Në parim ne kemi rënë dakord me qeverinë, me federatën për të financuar dhe bashkia do hyjë në mes si pronare toke. Kjo është në kuadrin e diskutimeve pa vendimmarrje, pra janë diskutime në parim, pra ne nuk kemi marrë vendim për të prishur stadiumin dhe as për të ndërtuar një tjetër për momentin. Mund ta kishim marrë por nuk e kemi parë të arsyeshme për shkak të debatit që u nxit dhe u mundohj të na nxirrte ne mosokër, betonizim, dhe këto

historitë e protagonizmit opozitar pa sens. Kjo është një projekt-ide që ne kemi në kokë. Nëse do bëhet konkrete, këtu do vijmë, në këshill, do diskutojmë. Do kesh rastin zonjë ta kundërshtosh, të japësh argument pro, kundra. Nuk ka një vendim të tillë. Mos dezinformoni fare opinionin publik. Nëse do ndodhë, do ndërtohen dy kate parkim dhe sipër do jetë një pendër multifunksionale rekreative ku dalin njerëzit dhe argëtohen. Do jetë një pedonale që nga "Milenium" te xhamia dhe do dalë një gjë e bukur që ke një projekt sot. N.q.s doni e sjellim me video këtu. Ne do vijmë në këshill të marrim një vendim bashkë, unë nuk jam privat që ta bëj si dua unë. Etiketimi që më bën mua personalisht është dashakeq, është i padrejtë sepse unë jam Kryetari i Bashkisë dhe politikat e zhvillimit miratohen këtu dhe zonjë, do jesh pjesë e vendimmarrjes pro ose kundra dhe do i nënshtrohesh vendimmarrjes së shumicës pavarësisht do jesh apo nuk do jesh dakord. Ne do zhvillojmë qytetin sepse nuk kemi një pendër argëtuese. Nuk kemi një parking dhe për shkak të kësaj ne ruajmë një rrëmujë trafiku dhe sa për atë që ne po dëmtojmë sportin

kjo është dështakaqe dhe helmuese sepse n.p.s do iki një stadium do ndërtohet një nga 2-3 herë më i bukur se ai, do ketë fusha rreth e rrotull, do ketë jo vetëm futboll por edhe sporte të tjera. Kur të doni vijmë në interpelancë se se paguhej për sportin dhe se paguajmë ne. dhe cilat janë arritjet në sport.

Alfrida Marku: Për pagesat për sportin ne delin dhe lidhje nepotike për pagesat që bëni ju

Pjerin Ndreu: Jo, nuk ka.

Alfrida Marku: Sa i përket stadiumit, e vlerësoj faktin që keni reflektuar, pra nga një vendim mesrjë e ezaurar të cilin e keni përcjellë në opinion publik gjatë fushatës dhe pas saj, N.p.s mendoni se sipërfaqja e stadiumit është e vetmja ku mund të zgjidhet problemi i parkimit, më lejoni të them që kjo është e gabuar. Lezha duhet të zhvillohet si një qytet policentrik

Pjerin Ndreu: Pse nuk e zhvillove kur ishte nënkryetare për 4 vjet.

Unë kam vënë piketat se çfarë mendoj unë për zhvillimin e qytetit, në fushatë, nuk kam marrë vendim. Me gjej se ku e kam artikuluar që është marrë vendim.

E kam sqaruar në tryezë me sportistët këtë gjë.

Nuk do gjesh kurrë as nepotizëm. Mund të kesh parë tim vëlla, por të bëj me dije që ka qenë basketbollist i ekipit "Besëlidhja" dhe është thjesht një njeri që do basketbollin.

Ndue Luli: Dua të sqaroj që vetëm zj. Markun por të gjithë këshilltarët se asnjë vendim nuk është marrë në këshillin e Bashkisë të Lezhës, për shembjen e stadiumit "Besëlidhja". Pra, këto fjalët që dalin, vërtet janë llafe pazari. Dhe tjetra, secili nga ne ka të drejtë t'i bëjë kërkesë këshillit, kryetarit të Bashkisë, drejtorive përkatëse, që t'i thërrasim në interpelancë për çështje të ndryshme për të cilat duam sqarime.

Së shpejti do kemi dhe planin tematik për vitin 2024, do thërrasim drejtorët dhe do jenë në rend dite, ku çdo drejtor do përgatitet mirë kur të vijë këtu.

Donika Hexhia: Përshëndetje.

Për sa i përket stadiumit, edhe unë e mora si shenjë reflektimi. Jam e qartë që nuk është një vendim, është një miratim plani.

U prish oracioni. Nuk ka pasë impakt pozitiv prishja e oracionit sepse fëmijët tanë që luajnë futboll, tani marrin furgonat për në sheshinat e Lezhës për të bërë stërvitje.

Si një banore e qytetit të Lezhës, është

mirë për të studim dhe historinë, traditën, të ruajmë ato objekte për gjënë pjesë e kësaj tradite. E kuptoj për ештë çështje votash, shumice.
Kam dhe një problem tjetër, ka të bëjë me pastërtinë e qytetit. Logjë e pezorit e ka të pamundur të përdorë në ballkone gjatë verës. Digjen mbeturina pafund. Unë jam për të marrë masa ndaj banorëve dhe për edukim. Pastaj për bashkia lejete fitimar dhe një projekt ku mund të organizohen dhe të rinjtë. E ngre këtë problem në emër të zonës.
Pjerin Ndreu: Ne nuk jemi këtu për thashetheme. N.q.s do ndodhë, do vijmë këtu. (Jep sërish sqarime në lidhje me stadiumin)
Sa i përket çështjes tjetër. Nuk digjen mbeturina, digjet bari që kositet, degët e pemëve, etj.
Në ndonjë rast sporadik ka djegie mbeturinash.
A ka akoma problem në menaxhimin e mbetjeve?
Po, ka. Ne do përgatisim një projekt vendim për çdo qytetar, kudo që e ka shtëpinë, do i nxjerrë mbeturinat me orar, në një vend të caktuar si e ka gjithë bota. Në p/buxhetin që vjen, ne do propozojmë pajisjen me kamera të gjithë qytetit, ku përveç sigurisë, fokus do jetë dhe menaxhimi i mbetjeve.
Çdo qytetar që i bie telefonit për të porositur

një problematikë, kryetari i bashkisë i përgjigjet.
Do bëhet një organizim në lidhje me ujërat.
Një problem shumë i madh janë lokalet e
dasmave në lidhje me ujërat. Do paguajnë
taksë më të madhe për shkak se prodhojnë shumë.
Mos të krahasojmë që kemi pasur tërmet, pandemi,
krizë ekonomike, kemi pasur turbulenca, nuk e
kemi pasur asfalt. Janë disa gjëra që do
i rregullojmë një nga një këtu në këshill.
Kemi transportin publik, sensorët e lëvizjes
nëpër qytet që do rregullohen, e të tjera
detyra që kemi për të bërë.

Ndue Luli: Fjalën e ka zoti Joku dhe
pas tij zoti Ndreca.

Tonin Joku: Çfarë është parashikuar në buxhetin
e vitit në vazhdim për sistemin vaditës në
njësinë Zejmen? Ndërkohë ka shumë vite që
hapen portat në lumin Mat dhe vetëm në
kanalin kryesor kalon ujë dhe nuk vadit asnjë
metër katror tokë bujqësore.
Pyetje tjetër: A kemi ndonjë shpresë për rrugën
në segmentin Milot-Lekë? dhe a është e
mundur nga bashkia të mirëmbahen rrugët e
fshatrave që lidhen me rrugën kryesore? Janë rrugë
që kanë popullsi dhe ku nuk është vënë dorë
mbi 30 vite, paftë dhe me stabilizant dhe kam
besim te z. Ndreca dhe gjej rastin ta falënderoj

për punën që ka bërë në mirëmbajtjen, pastërtinë e kanaleve kulluese.
Gjetja tjetër që ndodhte nuk është kompetencë e bashkisë - në lidhje me energjinë elektrike. Njësia Zejmen ka shumë probleme. Çdo ditë çohemi në mëngjes pa energji elektrike.
Dhe - është një fushë futbolli në Zejmen që nuk vihet dorë mbi të, vetëm kullosin bagëtitë, kap kisha.
Gjerin Ndreu: Për perceptimet, ne jemi pa projekt-buxhetit. Ajo që ka lidhje me ujin, në fakt i takon Bordit të Kullimit. Është një shpetësim që me Bordin, me Ministrinë e Bujqësisë mendoj se do ta kapërcejmë dhe nuk do ketë më probleme. Për rrugën Milot - Bellarc më është thënë nga kryeministri që do hapen procedurat. Shpresojmë që do jetë e vërtetë. Rrugët rurale i mirëmbajmë ne. Është një gjë që ne edhe në këshill me buxhetin dhe me Paketën Fiskale duhet të jemi më "agresivë" për arsye se në zonat rurale pagesa e taksave është e papërfillshme. Ne duhet të komunikojmë me njerëzit dhe do bëjmë një konsultim njësi për njësi. Do u kërkojmë njerëzve që n.q.s kërkon rrugë apo kërkon shërbim, duhet të paguash taksat. Ne kemi investuar sistemin elektronik të faturave të taksave dhe databaze

e gjithë biznesve dhe abonentëve familjarë po lidhet. Nuk ka ekzistuar. Një 3 vjet më kanë shkuar dëm edhe mua se mendoja se do e bënin e nuk e bënë. Duhet të paguajë secili ai sa i takon. Zona, n.p.s nuk paguan 80% taksat vendore, nuk ke si të marrë shërbim. Ju e dini që bashkia është administruese i taksave, nuk është shpikëse parash. Lekët e Shëngjinit do investohen në Shëngjin. Nuk mund të marrim lekë nga Shëngjini dhe t'i çojmë në Ungrej. p.sh.

Energjia është diçka që e kam marrë unë përsipër. Ia kam relatuar edhe kryeministrit. E kemi parë edhe në Shëngjin problem, që të jemi realistë.

Është një projekt i 100 fushave të futbollit. Një dy vende unë i kam përcaktuar. N.p.s doni e bëjmë atë fushën (është krah shkollës)

Esin Ndreca! Në fakt ajo që doja të thoja është një kërkesë, por ndërkohë më vjen mirë që shoh Kryetarin e Bashkisë të pranishëm dhe në pozitat e një dhënie llogarie që faktikisht mund të quajmë një standart të ri të vendosur, që duhet të ishte ndër vite. Është një mundësi shumë e mirë që na është dhënë të gjithëve të jemi pjesë e Këshillit Bashkiak, pjesë e vendimmarrjes

për të mirën e komunitetit. Do ji kutesha mirësisht që këtë kohë kemi të ryer ta shfrytëzojmë për të dhënë mendime që vlejnë, jo ta keqpërdorim duke u marrë me kamendësina, të zbatojmë dhe rregulloren. Është e drejta e gjithsecilit të japë mendimin e vet, aq më tepër në fushatë zgjedhore. Mendimin secili e shpreh dhe është shumica që vendos.
Doja të thoja që, me të vërtetë jemi te pika "Të ndryshme" por nuk mund të bëhet muhabet pazari këtu, ka rregulla, ka interpelanca.
Jam shumë dakord me atë që tha zonja për mbetjet por nëse është një bast që bashkia e ka fituar është menaxhimi i mbetjeve.
Ndue Luli: Fjalën e ka znj. Marku dhe pastaj z. Ndreu.
Alfrida Marku: Desha të shtroj 2 probleme.
Së pari: Çfarë masash ka marrë bashkia për fshatin Markatomaj të Nj. A. Zejmen i cili ose konkretisht mbi 70 familje të këtij fshati nuk furnizohen me ujë të pishëm ndërkohë që investimi për ujësjellësin kalon 3,3 mld lekë.
Së dyti: Sipas buletinit statistikor më të fundit të nxjerrë nga KLSH-ja, Bashkia Lezhë, thuhet shprehimisht atje, ka shkaktuar një dëm prej 402 mln lekë si pasojë e krijimit

të debitorëve për mosmbledhjen e taksave dhe tarifave vendore. Siç e kemi paraqitur edhe në mbledhjen e kaluar, kjo problematikë përkon edhe me periudhën zgjedhore. Për këtë arsye referuar nenit 64 të ligjit "Për Vetëqeverisjen Vendore", pika ç, duke marrë indicie nga raporti i kontrollit të Kontit të Shtetit, unë si anëtare e Këshillit të Bashkisë, njëkohësisht edhe në emër të grupimit politik që përfaqësoj, i kërkoj z. Ndreu që në mbledhjen e radhës të këshillit të raportojë mbi të dhënat e publikuara dhe konfirmuara nga KLSH si dhe të plotësojë detyrimin për të raportuar në këshill për gjendjen ekonomike financiare të bashkisë në 6 muajt e fundit.

Ndue Lulë: E pastë kërkesa juaj por duhet te bëni dhe me shkrim

Gjergj Ndreu: Në kuadrin e opozitës po sem ka njerëz që shkojnë poshtë e përpjetë dhe bëjnë sikur po shtyhen për komunitetin. E kanë lënë komunitetin pa një prej vitesh. Ai ujësjellës nuk ka mbaruar akoma. Ka pasë një defekt në Markatomaj që ka lidhje me një ndërhyrje në një profil shumë të vështirë, që nuk ka qenë e mundur të gjehet një mjet dhe punëtorët po e bëjnë me krahë. Mos u shpotiso se ne nuk kemi firmosur akoma përfundimin

e marrjes së lekëve, os marrjen në dorëzim të ujësjellësit. Kështu që mos u alarmo.
Alfrida Marku: Pse skepticizohesh?
Pjerin Ndreu: Nuk skepticizohem fare unë. Është një ndër krenaritë tona dhënia e ujit për një njësi komplet.
Ti kujton se do të të lë të bësh politikë me të padrejtën?
Për sa i përket të ardhurave, mirë do ishte të lexoji dhe ato kur ke pendë ti, do të shikoje se nga cili vit vijnë debitorët dhe do gjesh votën të shtyrë brenda. Jemi në mes të vitit buxhetor ose më saktë nga fundi dhe kur të mbyllet viti, ti mund të më gjykosh për të ardhurat. Brenda 4 viteve keni larë 4 mld borxhin tuaj. Keni dhënë rroga pa ardhë në punë fare, duke penë jashtë shtetit njerëzit kur të më thërrisni për të raportuar, unë vij raportoj. Ti ngrite një problem vetëm se lexove një rresht dhe pa u thelluar se ku fillon historia e ku mbaron.
Ndue Luli: Fjalën e ke z. Ndreu.
Artan Ndreu: Përshëndetje të gjithëve.
Është e pesta mbledhje që ne jemi në rrotullën e kryetarëve. Ju keni thënë që ditën e parë, më 14 maj ka mbaruar politika. Të ecim me gjëra konkrete. Një njeri që është provuar 4 vjet

dhe nuk ke bërë 4 punë, çfarë diskutojmë ne.
Se po të jetë diskutim i pastër politik, kjo
duhet të interesohet për banorët e vjetër të
asaj fushe. Kjo është opozitë. Se i përket
çështjeve të tjera, duhet që Kryetari i Bashkisë
mban flamurin për pastërti. Dyshoj se duan ta
forcojnë Kryetarin kur thonë se bashkia është e
papastër. Të lutem Kryetar të zbatosh rregulloren
në lidhje me kohën e fjalës.
Ndue Luli: Fjalën e ka z. Noke.
Pjetër Noke: Dy fjalë për këtë zonjën e
opozitës që flet kaq shumë. Të lutem shumë,
këtu jemi në mbledhjen e këshillit bashkiak,
jo në mbledhje partie. Zgjedhjet i ka fituar
z. Ndreu që ka punuar më shumë se të tjerët
për 4 vjet. Këtu në këshillin bashkiak flasim
për problemet e komunitetit.
Lirim Torba: Përshëndetje
Është mirë që debatet shtëpiake, mos t'i bëjmë.
Kam dy gjëra jashtë kompetencave të bashkisë,
për sa i përket sistemit të shpërndarjes së
energjisë elektrike. Desha të bëj një interpelancë
jo me shkrim për përfaqësuesit e sistemit të
shpërndarjes së energjisë elektrike. Të jenë të
paktën në mbledhjen e ardhshme ose në një
mbledhje tjetër për disa gjëra ose shpjegime.
Shtyllat e energjisë në disa vende janë në

mes të asfaltit në Kodër Marlekaj etj.
Desha të di a do ketë ndonjëherë njoftime kur të fiken dritat? Të gjithë biznesët punojnë me frigoriferë. Të paktën të kemi një informacion për rrjetin, në çfarë gjendje është këtë vit?
Më ankohen qytetarët që faturistët nuk shkojnë t'u lexojnë sahatet por u shkon faturë 340 lekë.
Agostin Marku: E kam krejt shkurt. E kam më tepër te efektiviteti i mbledhjes. Nuk kam asgjë personale me anëtarët e Këshillit.
Gjithsecili është në të drejtën e tij, që i jep ligji për të ngritur shqetësimet, por unë kam një problem që mua po më shqetëson. Kishim 12 pika në rendin e ditës. 11 pika ishin për probleme të ndryshme për mbarëvajtjen e punës në bashki. I kemi diskutuar dhe miratuar për 35 minuta. Çdo pikë e rendit të ditës ka kundërshti profesionale dhe kundërshti politike. Kundërshti profesionale nuk pati sepse kanë filluar funksionimin komisionet. Jemi ndalur 2 orë në komisionin e financës dje dhe jemi marrë vesh shumë mirë nga ana profesionale pozitë-opozitë dhe erdhëm me propozime përkatëse dhe u miratuan të gjitha. Ka dashur Zoti për kryetarin e Bashkisë që në këto 11 pika nuk

peti as kundërshti politike, çka do të thotë
për politika në këshill se i përket rendit të
ditës është me Kryetarin e Bashkisë.
Vijmë te pika "Të ndryshme". Po, duhet të
ngremë probleme, duhet të bëjmë deklarata,
duhet të ngremë shqetësime, por t'i kthejmë
në pyetje interpelanca, dhe ne kemi 1 orë
që nuk po merremi veç se ku jemi. Pse ndodh
kjo? Nuk po kuptojmë mirë sensin ç'është
interpelanca, ç'është ngritja e shqetësimit,
sepse në këto raste do kohë bashkia që
të përgatitet, dhe dalim me një përfundim
për një shqetësim që ka popullata. Kështu
ne nuk mund të vazhdojmë. Po e kthejmë
mbledhjen e këshillit në një bezdi.

- Kryetari: Z. Ndue Luli; dha fjalën qytetares Arilda Lleshi, që ishte e pranishme, e cila ngriti problemin e ndryshimit të Planit të Përgjithshëm Vendor që është miratuar në muajin prill 2023, në lidhje me konsultimet publike, që pretendonte që nuk janë ezauruar.
- Kryetari i dha fjalën qytetarit Ded Dede që mban detyrën e kryetarit të fshatit Zimaj, i cili ngriti problemin e varrezave dhe të një ure.
- Ndue Luli: Ka diçka tjetër?
- Arton Ndreu: Një sugjerim të vogël kam.

Pjesëmarrje në komisione është shumë efikase. Ai që nuk merr pjesë në komisione, për mendimin tim nuk ka të drejtë as diskutimi këtu.

Ndue Luli: Në lidhje me këtë, u bëj thirrje kryetarit, të/ kryetarëve, anëtarëve të komisioneve që t'i marrin seriozisht mbledhjet e komisioneve, të cilat janë paraprirëse të vendimeve për marrim në këtu në këshill, sepse një pjesë e mirë duke qenë specialistë të fushave na ndihmojnë edhe ne për të marrë vendimet e duhura.

- Kërkoi fjalën kryetari i Bashkisë i cili u kërkoi këshilltarëve që të sjellin sugjerime për zonat e tyre në njësitë administrative në lidhje me PBA-në.
- Kryetari z. Ndue Luli deklaroi mbylljen e mbledhjes.

| | |
|---|---|
| SEKRETARI | KRYETARI |
| FLORIDA ÇUNAJ | NDUE LULI |

Shënim: Mbledhja u transmetua live në Facebook në faqen "Këshilli i Bashkisë Lezhë".